



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Gjuha frënge

(klasa e nëntë)

Tiranë, 2008

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

I. TË PËRGJITHSHME

II. SYNIMET E PROGRAMIT

III. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE

IV. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

1. Tematika dhe leksiku

2. Aktet dhe funksionet e komunikimit

3. Struktura gramatikore

4. Shpërndarja e orëve

V. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

V. VLERËSIMI

I. Të përgjithshme

Programi i klasës së nëntë është parashikuar të realizohet në 105 orë mësimore me një frekuencë prej 3 orësh në javë. Ky program bazohet në ecurinë e programit pararendës për të propozuar një rritje spirale të njohurive gjuhësoro-kulturore dhe një rritje të shkallës së vështirësisë.

Në këtë fazë, nisur nga ecuria e nxënësve dhe vëllimi i njohurive të përvetësuar shkallë-shkallë në nivelet e mëparshme, programi, i bazuar në përshkruesit e aftësive sipas *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave*, synon të realizojë një nivel të ndërmjetëm **midis A2+ dhe B1**. Në fakt një nivel i tillë nuk gjen pasqyrim në *Kuadrin e Përbashkët të Referencave*, por meqë pikërisht aty rekomandohet fort nevoja e përshtatjes së parametrave dhe tabelave të përshkruesve të këtij dokumenti sipas kontekstit dhe kushteve specifike kombëtare, është krijuar ky nivel i ndërmjetëm duke dozuar shkallën e vështirësisë në mënyrë që ajo të jetë më e lartë se niveli A2+(niveli i klasës së tetë dhe më e ulët se B1 (që duhej të ishte niveli i klasës së tetë)). Sigurisht, për të hartuar këtë nivel jemi bazuar në të dhënat dhe klasifikimet e përshkruesve të nivelit A2+ dhe ato të nivelit B1 të *Kuadrit të Përbashkët të Referencave*.

Është vendosur një nivel i tillë, pasi, sipas mësueve të gjuhëve të huja, kushtet e arsimit tonë institucional, klasat e mëdha në numër dhe përbërja e tyre heterogjene nuk na lejon një kalim të drejtpërdrejtë në **nivelin B1**.

Duke mbajtur parasysh faktin se nxënësit e klasës së nëntë janë të rritur tashmë dhe zotërojnë jo pak kompetenca, ky program do të parashikojë më shumë veprimtari me shkrim dhe do të rrisë gjithmonë e më shumë aftësinë e tyre për t'u bërë autonomë e krijues. Theksi do të vihet në ato që quhen operacione të nivelit të lartë (konjitivokrijuese) dhe më pak në operacionet e nivelit të ulët (ato të automatizuara).

Në këtë nivel programi mund të ruajë ekuilibrin midis katër aftësive.

II. Synimet e Programit

a) synimet edukative

Në këtë nivel mësuesi synon të praktikojë më shumë veprimtari që stimulojnë punë individuale, nga njëra anë, sepse nxënësi në sajë të njohurive ndihet gjithmonë e më i sigurt për të kryer i vetëm detyrat dhe veprimtaritë e ndryshme dhe nga ana tjetër, sepse në këtë nivel synohet të zhvillohet individualiteti krijues i nxënësit. Në këtë fazë nxënësi merr pjesë në detyra të cilat nxisin të shprehë opinionin e tij ose të japë informacion. Flasim për veprimtari *të krijimit*, nëse duam të vëmë theksin në operacionet e zbatuara dhe për veprimtari *të shprehurit*, nëse ngulmojmë në qëllimin final.

Megjithatë edhe në këtë nivel programi do të vazhdojë të propozojë veprimtari në grup për të ndjekur kështu një pedagogji të diferencuar, meqë jo të gjithë nxënësit kanë të njëjtin nivel. Në këtë kuadër mësuesi do të stimulojë nxënësit që të ndërmarrin vetë nismën për punë në grupe, shfrytëzim të mjedisit, shkëmbimet midis shkollave, konkurse, letërkëmbimet etj

Në këtë nivel synohet që nxënësi të bëhet sa më i pavarur.

Të mësosh të bëhesh i pavarur do të thotë...

- të mësosh të konsultohesh **instrumentat e punës** (manualë, fjalorë, gramatika) si dhe qendrat burimore të vetëformimit;
- të mësosh të **përdorësh burime të tjera informacioni** dhe shkëmbimesh përveç shkollës;
- të mësosh të krijosh **instrumentat vetjake** ose materialet e të mësuarit;
- të mësosh të **vetëvlerësohesh**;
- të mësosh të **analizosh nevojat e tua të të mësuarit**;
- të mësosh të **njohësh stilin vetjak të të mësuarit**;
- të **fitosh besim në vetvete**; të njohësh pikat e tua të forta;
- të zotërosh **shprehitë e punës**;
- të jesh i aftë të **kryesh shkëputjen semantike dhe kulturore**, për t'u distancuar nga universi yt që të përqafosh një univers të huaj;
- të ndëtosh strategjitë e tua të të nxënit

b) Objektivat didaktike

Në klasën e nëntë, në nivelin mbi A2+ deri në B1, programi do të vazhdojë të nënkuptojë ndërthurjen e të katër aftësive duke parashikuar gjithashtu jo vetëm konsolidimin dhe rimarrjen në një shkallë më të lartë të elementëve gjuhësorë dhe kulturorë të programit të klasës së tetë, por edhe futjen e njohurive të reja më të vështira. Në këtë nivel nxënësi do të jetë midis nivelit të mbijetesës A2+ (si përdorues fillestar) dhe nivelit prag B1 (si përdorues i pavarur). Sipas *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave*, objektivi i përgjithshëm i këtij niveli është që **nxënësi të kuptojë pika themelore në një gjuhë të thjeshtë dhe standarde në lidhje me fusha që kanë përparësi imediate dhe tema të njohura dhe me interes për të si dhe të mund të prodhojë një ligjiratë të thjeshtë mbi tema shumë të njohura me fjalë të thjeshta.**

Objektivat didaktikë edhe në këtë nivel do të zërthehen gjatë programit në disa miniobjektiva për nxënësit, si më poshtë:

- të kuptojë udhëzime të thjeshta për t'u orientuar në rrugë ose për arritur në destinacion;
- të kuptojë pikat dhe temat kryesore të lajmeve në televizor, të mbështetura me pamje vizive;
- të nxjerrë pikat thelbësore të mesazheve e lajmërimeve të shkurtra;
- të gjejë kuptimin e fjalëve të panjohura nga një kontekst i thjeshtë dhe familjar;
- të ndjekë dhe të kuptojë thelbin e një bisede, me kusht që gjuha të jetë e qartë dhe standarde;
- të kuptojë instruksione të thjeshta të elektro-shtëpiakëve.

Programi nënkupton ndërthurjen e objektivave komunikative, gjuhësore dhe socialkulturore

Edhe në këtë nivel, **objektivi komunikativ** mbetet shumë i rëndësishëm. Nxënësi është më i ndërgjegjësuar për mësimin e gjuhës së huaj dhe përdorimin e saj. Në këtë fazë ai e kombinon objektivin komunikativ me aftësinë **pragmatike**, për të realizuar qëllimet e tij imediate dhe të ardhshme nëpërmjet realizimit të funksioneve gjuhësore e akteve të të folurit. Në këtë nivel nxënësi është i ndërgjegjshëm për rregullat e mirësjelljes dhe di si të hyjë në marrëdhëniet shoqërore.

Lidhur me realizimin e **objektivit gjuhësor**, programi parashikon përvetësimin e njohurive të leksikut dhe fonetikës, morfologjisë e sintaksës duke synuar krijimin e përdoruesve të pavarur të gjuhës. Njohuritë gjuhësore në këtë fazë përdoren gjithnjë e më shumë në mënyrë të ndërgjegjshme, duke përdorur më pak operacionet e nivelit të ulët (të automatizuara) dhe më shumë operacionet e nivelit të lartë, si:

- vendosja e lidhjes midis nivelit pamor nga njëra anë, me nivelin fonetik dhe prozodik, nga ana tjetër (lidhur me leximin)
- mospajtimi në kohë në këtë lidhje për të ruajtur një lexim të rrjedhshëm; lëvizja e syrit është më e shpejtë se sa e folura;
- identifikimi i strukturës së tekstit;
- integrimi semantik i të gjithë tekstit.

Për realizimin e **objektivit social-kulturor** në këtë nivel, programi parashikon shtimin e dokumentave autentike që kanë të bëjnë me kulturën e vendit, gjuhën e të cilit mësojnë. Në këtë fazë elementët e civilizimit janë më të shumtë, të shoqëruara me imazhe e foto. Njohja e zakoneve, qëndrimeve e normave të huaja i ndihmojnë nxënësit të orientohen dhe të bëhen të pavarur për t'u orientuar dhe për të plotësuar nevojat imediate në një vend të huaj. Duke përdorur funksionet gjuhësore nxënësi arrin të përdorë rregullat e mirësjelljes dhe të kërkojë informacione pranë një komuniteti të ndryshëm nga ai i veti

III. Përshkrimi i aftësive gjuhësore

Programi në përputhje me rekomandimet dhe parimet e kurriulës kombëtare synon formimin e katër aftësive, por në këtë nivel ai i jep përparësi kompetencës komunikative me gojë dhe me shkrim si dhe prodhimin me shkrim.

1. Të dëgjuarit

Në këtë nivel, sipas *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave*, **nxënësi mund të kuptojë mjaftueshëm për t'iu përgjigjur nevojave konkrete si dhe mund të kuptojë pikat kryesore në një bisedë mbi tema të hasura më parë me kusht, që e folura të jetë e qartë, gjuha standarde dhe debiti mesatar.**

Nxënësi është i aftë:

- të komunikojë edhe me folës të lindur (përshëndetje, leje për t'u larguar, felenderime, etj.);
- të kuptojë udhëzimet gojore, të shqiptuara qartë nga mësuesi ose një nga anëtarët e grupit (në punë në grup) për të kryer një detyrë të caktuar;
- të kuptojë edhe emisione të thjeshta televizive, të mbështetura me elementë pamorë, programe të medias dhe filma të thjeshtë;
- të ndjekë një bisedë të qartë dhe standarde, duke bërë hera –herës pyetje dhe nëse folësi i përsërit fjalët apo fjalitë dhe bën riformulime kur kjo i kërkohet;
- të komunikojë për të përballuar situata të ndryshme gjatë një udhëtimi

2. Të lexuarit

Në nivelin mbi A2+ (ose fillimi i B1) nxënësi **mund të kuptojë tekste të shkurtër e mesatarë të hartuar në një gjuhë të thjeshtë dhe standarde. Mund të kuptojë përshkrime, tregime të shkurtra të ilustruara, urime, letra personale.**

Nxënësi i klasës së nëntëeshtë i aftë:

- të kuptojë tekste të shkurtra, me gjuhë të thjeshtë ku mbizotëron gjuha e përditshme, me tema të përditshme, si dhe tekste faktike që lidhen drejtpërsëdrejti me interesat e tij;
- të njohë dhe të kuptojë letra standarde të zakonshme (kërkesë informacioni, porosi, konfirmim, etj.) si dhe të mbajë një korrespondencë me një mik;
- të kuptojë një rregullore ose një lajmërim;
- të kuptojë pikat kryesore në artikuj të shkurtër me material faktik dhe mbi një temë të njohur;
- të nxjerrë nga konteksti kuptimin e ndonjë fjale të panjohur me kusht që teksti të trajtojë një temë shumë të njohur e familjare për të.

3. Të folurit

Në këtë nivel, **nxënësi mund të bëjë shkëmbime të thjeshta në gjuhë standarde në fusha me përparësi imediate dhe mund të tregojë një përvojë , një shpresë apo qëllim shkurtimisht.**

Nxënësi i klasës së nëntëeshtë i aftë:

- të komunikojë në situata shkëmbimi për të dhënë ose marrë informacion;
- të marrë pjesë në biseda me tema të njohura që lidhen me jetën e tij të përditshme (familja, aktualiteti, udhëtimet, koha e lirë etj.);
- të tregojë një tregim të shkurtër;
- të paraqesë një propozim.

Në këtë nivel, nxënësi do të vazhdojë të përdorë shprehje të ngulitura, por ai mund të marrë pjesë në bisedë me një fjalor të mjaftueshëm e me struktura dhe skema të thjeshta të gjuhës së përditshme, lidhur me tema të njohura. Ai mund të flasë në mënyrë të kuptueshme, ndonëse me pauza për të kërkuar fjalët e frazat, duke bërë gabime dhe korrigjime herë pas here.

Në nivelin A2+deri B1 që nënkupton një nivel më të lartë se ai i mbijetesës drejt nivelit prag, nxënësi është i aftë:

- të fillojë, të vazhdojë dhe të mbyllë një bisedë të thjeshtë me kusht, që ajo të zhvillohet ballë për ballë;
- të bëjë shkëmbime të thjeshta, të përditshme pa vështirësi të mëdha;
- të kuptohet nga të tjerët kur shkëmben ide mbi tema të njohura të parashikuara me kusht që bashkëfolësi ta ndihmojë;
- të ndërveprojë me një lehtësi relative në situata të strukturuar;
- të bëjë një monolog, ku shpreh prshtypjet e tij me fjalë të thjeshta dhe të përshkruajë sende dhe ngjarje të njohura.

4. Të shkruarit

Në nivelin midis A2+dhe B1, sipas *Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave*, nxënësi **mund të shkruajë mesazhe të thjeshta dhe të shkurtra, letra personale falenderimi dhe tekste të shkurtër mbi tema të njohura.**

Nxënësi i klasës së nëntë është i aftë:

- të shkruajë një seri frazash me shprehje të thjeshta si dhe një tekst të shkurtër, koherent mbi një temë të njohur duke përdorur artikulesit;
- të përshkruajë mjedisin, njerëzit, shkollën, etj.;
- të përshkruajë ndjenjat dhe ragimet e tij, etj.;

- të shkruajë letra personale duke përkthyer përvoja, ndjenja, ngjarje;
 - të shkruajë shënime apo letra, për të transmetuar informacione me interes imediat dhe të vëjë theksin në pikat e rëndësishme;
 - të parafranojë pjesë të shkurtra, të shkruara, duke përdorur fjalët dhe planin e tekstit.
- Në këtë fazë nxënësi nxitet gjithmonë e shumë drejt krijimeve të mirëfillta me shkrim

IV. Përmbajtja e programit

1. Tematika dhe leksiku

1. Le quotidien

- amitié, amis et connaissances
- soirées, fêtes, distractions (cinéma, théâtre, disco)
- culture et Média
- loisirs
- ma maison et ma famille
- ma journée

2. La vie publique

- santé, régime, médecin, qualité de vie
- le marché, les magasins, les achats
- au restaurant, à l'hôtel...
- relations avec les autres (chez le directeur...)
- Les sports et l'esprit de compétition, le stade...
- Les affiches, les avis, les prospectus, les publicités ..

3. Le tourisme et les voyages

- chaîne hôtelière, station de sport d'hiver, la plage
- le tourisme culturel- musée, monuments,
- fouilles archéologiques, villes antiques
- pays – paysages, sites et coutumes à découvrir
- cuisine (plats et boissons)
- aéroports, trains, ports, agences de voyages

4. L'environnement, la nature, les pays

- la pollution et les bruits
- la vie à ville/ la vie à campagne
- beauté de la nature
- le climat
- l'avenir du monde

5. Services et prestations

- café Internet, e-mail (message)

- portable, cabine téléphonique, sms (communication téléphonique)
- mode d'emploi de l'Internet
- improviser un "chat" sur Internet.

6. La vie personnelle

- Souvenirs , jeux, le monde familial et scolaire
- Les professions et mon aspiration
- Projets et professions futurs, rêves de l'avenir
- Mes préférences et mes loisirs

7. Culture et média

- Le cinéma-les films que je préfère, avantages et inconvénients du cinéma
- La télé, émissions plus suivies, enquête des spectateurs
- La Radio, opinion, nouvelles.
- Une bande dessinée (comment la rédiger?)

2. Aktet dhe funksionet e komunikimit

- Demander et donner son opinion
- Parler des professions
- Exprimer des sensations (c'est agréable.. c'est délicieux..) et des sentiments (joie, sympathie, craintes, chagrin etc)
- Proposer une sortie, inviter au restaurant, organiser une fête...
- Formuler et rédiger une annonce, un CV, une publicité
- Savoir engager, continuer et clore une conversation (à propos...dis donc... tu sais que etc)
- Exprimer la douleur, le malaise (je suis malade, souffrant, j'ai mal à...etc)
- Raconter une histoire, des impressions (vacances, etc) un petit récit
- Commenter des nouvelles, un article, un film, une émission, une pièce de théâtre etc
- Préparer un voyage... faire le compte rendu d'un séjour
- Ecrire lettre, sms, e-mail, improviser le "chat" sur Internet
- Parler musique
- Parler distractions et loisirs
- Les nombres de 200.....

3. Struktura gramatikore

Reprise de la négation (avec l'impératif p. ex) et de l'interrogation (inversion)

Répondre oui/non à une question à la forme négative

L'emploi de qui, quel / quelle/quels/ quelles

Adjectifs et pronoms possessifs notre, votre, leur et le nôtre....

Pourquoi/ parce que

Les ordinaux premier, second...

Les moments de la journée et les prépositions introductives, ou les articles

Etre en train de faire...

L'emploi du futur proche et d'un pronom... ex Le livre? Je vais *le* lire
Verbes du 3e groupe et irréguliers ex. dire, permettre, interdire etc
L'utilisation de celui-ci, celle-ci (là)....
L'ordre des pronoms personnels, objets (ex dans des phrases negatives, à l'impératif etc)
Constructions prépositionnelles: commencer à, parler (à, avec, de), jouer de + instrument
de musique; jouer à (des jeux) aux cartes, aux échecs...
Les semi-auxiliaires + infinitif (vouloir, pouvoir +faire)
Initiation au discours indirect
Le subjonctif, principe de formation, valeur et emploi. – Il faut que + subjonctif

4.Aspekti fonologjik

Në këtë nivel nxënësi mund të realizojë intonacionin, prozodinë e melodinë e frazës si dhe mund të adoptojë ritmin e duhur duke shmangur ngurrimet e ndalesat dhe duke siguruar një debit të përshtatshëm.

5. Shpërndarja e orëve

Orë mësimore: 35 javë x 3 orë = 105 orë

90 orë mësimore (18 unitete x 5orë = 90 orë)

15 orë të lira në dispozicion të mësuesit (përsëritje, detyra me shkrim, lexime të pavarura, biseda me tematika të ndryshme, orë leximi pjesësh të zgjedhura, projekte pedagogjike etj).

Qëllimi *i orëve të lira* (rreth 10% e orëve totale), është që t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësit në përputhje me kërkesat e programit zyrtar, të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për lëndën e Gjuhës Frënge dhe Udhëzimin Nr. 38, dt. 9.10.2007 i MASH për orët e lira.

Organizimi i lojërave gjuhësore me elementë që zhvillojnë të menduarit logjik dhe kritik në shërbim të një objektivi të paracaktuar; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojëra të ndryshme zbavitëse; përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënit, ashtu edhe mësimdhënien janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesi/et e lëndëve të tjera, duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët (në formën e një projekti ose të një teme komplekse), që shfrytëzon lidhjet konceptuale të gjuhës frënge me lëndët e tjera dhe aspektet ndërkurrikulare.

Shpërndarja dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve në vendin e duhur përgjatë procesit mësimor akademik është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës së orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar kryesisht për qëllime rutinë, të cilat nuk ndihmojnë në arritjen e objektivave të këtij programi.

V. Metodologjia e zbatimit të programit

Në këtë nivel A2+ me elementë të B1, mësuesi do të vazhdojë të adoptojë një metodologji që e konsideron gjuhën si sistem dhe për rrjedhojë, të koordinojë veprimtari që synojnë të 4 aftësitë, dmth: të punosh me kompetenca të integruara. Sidoqoftë në këtë fazë, ai mban parasysh se nxënësi duhet të jetë një lexues **i pavarur** që në të ardhmen do të lexojë jo vetëm për kënaqësi, por edhe për qëllime të caktuara. Me qëllim që të thyhet leximi linear dhe të shmangen bllokimet në të kuptuarit e teksteve, ai mund t'i iniciojë nxënësit në **disa strategji** të të lexuarit si: leximi diagonal, leximi skremues, leximi spastrues etj. Në këtë kuadër është e rëndësishme që nxënësve t'u jepen mjete pune dhe ata vetë të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për procesin e të mësuarit. Nxënësi vihet në situatë aktive, me qëllim që ai të mobilizojë të gjitha mjetet që zotëron, pasi gjatë procesit të të mësuarit, ai mund të kërkojë të dhëna, të përqsë terma, të ngrejë hipoteza, të bëjë një listë me elementë kuptimorë.

Në këtë fazë funksioni metagjuhësor i gjuhës rritet.

Mësuesi mund të **ndryshojë funksionin e caktuar** të teksteve dhe dokumenteve.

Për një tekst të dhënë, veprimtaritë e propozuara do të ndryshojnë sipas qëllimit, pra, nëse lexojmë për kënaqësi, për një sensibilizim lidhur me përdorimin e kohëve foljore ose për të gjetur informacion.

Mësuesi në këtë fazë duhet të synojë, sigurisht, rritjen e shkallës së vështirësisë në formulimin e kërkesave të detyrave, duke u nisur nga niveli i mëparshëm, psh: ai mund të kalojë nga të **kuptuarit e përgjithshëm** (në klasat më të ulëta) shkallë –shkallë në të **kuptuarit thelbësor, të kuptuarit e saktë, të kuptuarit interpretues**, etj

Metodologjia e ndjekur nga mësuesi synon kalimin nga më e njohura te më pak e njohura, nga proceset e automatizuar tek ato krijuese.

Për sa i përket të mësuarit të gjuhës në përgjithësi, mendojmë se vetëm të kuptuarit nuk mund të çojë në mësimin e plotë të gjuhës: është krijimi ai që në fund të fundit, është vendi i praktikimit të njohurive. Sipas objektivave institucionale, shprehive dhe motivimit të nxënësve mund të vendosim marrëdhënie të ndryshme midis kuptimit dhe krijimit. Megjithatë një distancë midis tyre është gjithmonë e nevojshme, nga njëra anë, sepse kështu ndodh në gjuhën amtare (gjithmonë kuptojmë më shumë sesa mund të shprehim), nga ana tjetër, sepse të kuptuarit kërkon një organizim të të dhënave që shërben si bazë për punën gjatë krijimit. Sidoqoftë në këtë fazë, mësuesi i lë një hapësirë më të madhe **produktit me shkrim**, duke favorizuar operacionet e nivelit të lartë dhe jo vetëm proceseve memorizuese. Kështu, mësuesi do të synojë në këtë fazë, që nxënësi të kalojë nga **riprodhimi** i thjeshtë, (karakteristik për klasën e gjashtë, por disi edhe në klasën e shtatë) te e **shprehura më e larmishme, krijimi gjuhësor dhe improvizimi**, nga e **shprehura e drejtuar** te e **shprehura vetjake**. Mësuesit, duke favorizuar në këtë klasë shkrimin i cili lejon vëzhgimin dhe ka një dimension individual, do t'i duhet të ridimensionojë vëllimin e veprimtarive me shkrim, duke i lënë më shumë vend punës individuale, sesa punës në grup.

Në këtë nivel, synohet të krijohen kushtet e përshtatshme për t'u shprehur ose për të shkruar. Është fjala për të vënë në punë gjithçka për të krijuar një klimë të përshtatshme në klasë. Ja disa faktorë që mund të ndihmojnë: identifikimi me tjetrin, loja, humori, larmia dhe shprehësia e zërave që futen në klasë, pasuria grafike e dokumenteve të shkruar, veprimtaritë e reflektimit mbi komunikimin dhe të sensibilizimit për të folurit, teknikat e korrigjimit, zbatimi i një vlerësimi të qartë.

Në një mësimdhënie të gjuhës për qëllime komunikimi, është e domosdoshme të krijosh një motivim për të folur që të jetë sa më i justifikuar: simulim nevojash (vënie në skenë në klasë, simulime të përgjithshme, situata komunikimi të qarta), parashikim i nevojave (përdorim i gjuhës së huaj për parashikime, për qëllime të caktuara, studimi apo turizmi, për shembull), nevoja reale, brenda klasës ose që vijnë nga kontaktet jashtë klasës (punë në grupe, shfrytëzim i mjedisit, shkëmbimet midis shkollave, letërkëmbimet telematike, me internet, ose me kasete audio ose video), por edhe kënaqësia për të luajtur, për të komunikuar, për t'u shprehur dhe për të dëgjuar tjetrin.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i metodologjisë së zbatimit të programit është **integrimi lëndor**. Në kushtet e realizimit të procesit të mësimdhënies/të mësuarit të gjuhës së huaj, ky aspekt zbatohet nëpërmjet rubrikës së "Civilizimit". Në këtë rubrikë, mësuesi trajton elementë të gjeografisë, kur p.sh trajtohet turizmi detar, malor apo sportet e ndryshme aspekte historike (p.sh. figura historike si Jeanne d'Arc, Napoléon etj), aspekte kulturore e letrare (p.sh artin kulinar e gastronominë, kinemanë, muzikën, etj), të cilat mund t'i realizojë nëpërmjet shfaqjeve të filmave, tregimeve të ilustruara, mësimit të këngëve e poezive etj . Në këtë mënyrë programi përmbush edhe një funksion konjitiv duke u mundësuar nxënësve jo vetëm mësimin e gjuhës, por edhe të mësuarit nëpërmjet gjuhës, pra gjuhën si objekt dhe si mjet të të mësuarit.

VI. Vlerësimi

Në nivelin A2+ deri në B1, mësuesi do të vazhdojë të koordinojë format e ndryshme të vlerësimit si dhe do t'i lërë një vend më të madh vetëvlerësimit dhe bashkëvlerësimit, meqë nxënësi i rritur është gjithnjë e më i ndërgjegjshëm për procesin e të mësuarit.

Mësuesi në këtë fazë do të synojë të zbatojë kritere specifike vlerësimi, pra mund të masë realizimin e objektivave të caktuara, në periudha të caktuara të procesit mësimor me anë të testeve. Ai do të vazhdojë të praktikojë kontrollin e vazhduar. Duke njohur autonominë në rritje të nxënësit në këtë nivel, është e natyrshme që kriteret e vlerësimit të jenë të larmishëm.

Për të arritur pavarësinë, nxënësi duhet të jetë në gjendje t'i gjykojë krijimet e tij në lidhje me atë çka pritet prej tij: pak nga pak ai duhet të përvetësojë kritere vlerësimi, që shpesh caktohen nga jashtë. Vetëvlerësimi është një i mësuar progresiv, që duhet integruar në disa veprimtari.

Ja disa mini-veprimtari ose kërkesa për vetë-vlerësimin formues:

- të shpjegohen objektivat pedagogjike të veprimtarive;
- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja "Çfarë keni mësuar?";
- t'i kërkohet rregullisht nxënësit të bëjë bilancin e njohurive të ndryshme;
- të shpallen provimet e vlerësimit përmbledhës dhe të përcaktohen paraprakisht kriteret e suksesi;t

- në një situatë suksesi, të pyeten nxënësit “Çfarë bëtë për të pasur sukses?” dhe të nxiten ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
 - pas një krijimi me shkrim, t’i kërkohet nxënësit të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (duke nënvizuar, për shembull)
 - në rast mëdyshjeje mbi një formë ortografike, leksikore ose morfologjike, t’i kërkohet nxënësit ta shënojë këtë formë në tekstin e tij dhe të hartojë pyetjen në fund të faqes në formë shënimi (mësuesi i përgjigjet në të njëjtën mënyrë).
- Gjithashtu mund t’i kërkohet nxënësit të hartojë një skedë vetë-korrigjimi, për të korrigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta ose ta integrojë korrigjimin në veprimtarinë e kërkuar. Në veprimtarinë e mëposhtme, do të përpiqemi të paraqesim përfytyrimet që ka nxënësi për suksesin e një veprimtarie të dhënë.

“ Mendoni se keni pasur sukses?”

Objektivat

- Ta mësojmë nxënësin të vendosë veten në lidhje me kushtet e duhura të suksesit.
- Ta mësojmë t’i shohë krijimet e tij me sy kritik.
- Të nxjerrim në pah disa përfytyrime që ka nxënësi për punën e tij vetjake dhe për atë që ai e quan sukses.

Ecuria

- Pas një veprimtarie krijimi ose vlerësimi, pyesim çdo nxënësi se ç’notë ose ç’vlerësim ai (ose ajo) mendon të marrë dhe pse. Kjo pjesë e dytë e pyetjes zbulon përfytyrimet që ka nxënësi për rezultatin e arritur dhe për raportin ndërmjet punës së tij dhe krijimit të pritur.
- Kur bëhet korrigjimi, është shumë e dobishme për nxënësin të krahasojë vlerësimin e marrë dhe vlerësimin e pritur.

Ç’notë mendoni të merrni dhe pse?

Shembuj përgjigjesh të dhëna nga nxënësit e vitit të dytë për pyetjen e mëposhtme, të bërë me shkrim pas një veprimtarie vlerësimi (klasë me 15 nxënës)

Disa nxënës i japin vetes një notë të mirë me argumentat e mëposhtëm:

- ... sepse nuk m’u duk e vështirë,
- ... sepse më mungonte fjalori,
- ... sepse i ngatërrova gjëra ,
- ... sepse kam vështirësi me parafjalë,t
- ... nuk japin asnjë shpjegim

disa nxënës i japin vetes notën mesatare:

- ... sepse nuk shkoi mir,ë
- ... sepse kam vështirësi me nyjat,
- ... sepse nuk dita t’i përgjigjem pyetjes mbi itinerarin

disa nxënës i japin vetes më pak se mesatarja:

- ... sepse nuk shkoi mirë,

-... sepse nuk kam punuar sa duhet,

-... sepse nuk ia dal asnjëherë mbanë, megjithë përpjekjet

Vërejtje

Këto rezultate tregojnë se të gjithë nxënësit nuk kanë të njëjtin perceptim për suksesin. Mund të mendojmë se ata që pohojnë “Nuk m’u duk e vështirë” dhe i japin vetes 12/20 kënaqen *a priori* me këtë rezultat, ndërsa ata që i japin vetes po këtë notë duke thënë “I ngatërrova gjërat”, ishin *a priori* më ambiciozë.

Dallime të ndjeshme ka edhe ndërmjet atyre që i japin vetes notën mesatare duke thënë: “Nuk shkoi mirë” dhe atyre që përcaktojnë shkakun e saktë të vështirësisë: “Kam vështirësi me nyjat”. Situata (pyetje e shkruar “aty për aty”) nxjerr në pah tek disa njëfarë dekurajimi i cili duhet mbajtur parasysh (duket se është rasti i përgjigjes së fundit)

Krahasimi i mëvonshëm i notës së marrë me notën, që secili i kishte vënë vetes, është tregues i mendimit që ka secili për aftësitë e tij. Me të vërtetë mund të gjejmë rastin e nxënësit që është i bindur se do të marrë notë të keqe dhe që ka dalë mirë ose rastin e atij që deklaroi “M’u duk i lehtë” dhe që zbulon mangësi.